



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 814/7 prot

Datë 26.05.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 494/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.05.2022 me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Autoasja” ShA në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me tender kryesor Nr. REF-19189-02-09-2022, ankimohet procedura e prokurimit me Nr. REF-19195-02-09-2022 me objekt: Loti II “*Blerje bateri për automjete*” me fond limit 32.453.736 lek pa TVSH, zhvilluar me datë 15.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Autoasja” Sha  
Adresa: Lalm, Vaqarr, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, Tiranë
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Alked Kopaci” PF  
Adresa: Njësia Bashkiake nr 7, Rruga e "Kavajës",  
Pallati nr 102, Shkalla nr.1, Kodi postar 1023, Tiranw
- Baza Ligjore:** Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. Nenet 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e*

*Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.02.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me tender kryesor Nr. REF-19189-02-09-2022, ankimohet procedura e prokurimit me Nr. REF-19195-02-09-2022 me objekt: Loti II “Blerje bateri për automjete” me fond limit 32.453.736 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 15.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 07.04.2022, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik për kualifikimin apo skualifikimin e tyre.

II.3. Në datën 11.04.2022 autoriteti kontraktor, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 20.04.2022 operatori ekonomik “Autoasja” Sha, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Alked Kopaci” Pf në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të

dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 814/2 datë 21.04.2022, lidhur pretendimet e operatorit ekonomik “Autoasja” sha për mospërmbushjen e disa kritreve nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Alked Kopaci” Pf.

II.6. Në përfundim të afatit ligjor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin e trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 814/4 prot., datë 05.05.2022, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepet argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, të jepet informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion, për depozitimin e ankesave, apo argumenteve nga subjektet e interesuara pranë autoritetit kontraktor dhe trajtimin e tyre, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Autoasja” Sha.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 717 prot., datë 05.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 814/5 prot., datë 09.05.2022 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi për shqyrtimin e ankesës lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Nga verifikimet e kryera, rezulton se janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekti i interesuar operatori ekonomik “Alked Kopaci” Pf, protokolluar me tonën nr. 814/3 datë 27.04.2022 lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Autoasja” SHA, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

II.9. Nëpërmjet shkresës datë 14.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 814/6 prot., datë 16.05.2022 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik shkresa e operatorit ekonomik “Auto Kopaci” PF për argumentimin e afateve procedurale të dorëzimit të argumenteve në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Autoasja” SHA.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Autoasja” SHA mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Referuar shkresës nr. 717 prot., datë 05.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 814/5 prot., datë 09.05.2022 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara me nr 639/2 datë 04.05.2022 mbi shqyrtimin e ankesës lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se ankesa është pranuar duke cituar: “[...] Pranimin e ankesës se paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Asja” Sha. [...]”

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:  
1. *Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.*

2. *Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.*

*Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.*

3. *Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:*

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

5. *Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.*

6. *Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

- a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
  - ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
  - b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
  - c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.
3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:
- a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;
  - b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.2. Lidhur me argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik “Auto Kopaci” PF, respektivisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, argumente për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Autoasja” SHA, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Me shkresën nr. 717 prot, datë 05.05.2022 me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 2 “Blerje bateri për automjete””, protokolluar me tonën me nr. 814/5 prot datë 09.05.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi nr.639/2 prot., datë 04.05.2022 i autoritetit kontraktor, në lidhje me shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Autoasja” SHA, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar plotësisht ankesën e tij.

III.2.2. Në nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”

III.2.3. Ndërsa në nenin 114 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.2.4. Në nenin 120 pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “2. Me paraqitjen e ankesës, operatori/ët ekonomikë të interesuar, i cili/të cilët nuk është/janë dakord me vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor, detyrohet/detyrohen të paguajë/ paguajnë tarifën e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.2.5. Në nenin 99 pika 3 dhe pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“3. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e argumenteve, sipas pikës 1, të këtij neni, është 7 (shtatë) ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, ky afat është 5 (pesë) ditë.

4.Nëse operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të kësaj pike, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”

Ndërsa në nenin 100 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 4 dhe 5, i ndryshuar, parashikohet:

“4. Autoriteti/enti kontraktor merr vendim, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 114, të LPP-së, dhe vë në dijeni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4, të këtij neni.”

III.2.6. Sa më sipër, nisur nga argumentet e operatorit ekonomik “Auto Kopaci” PF, vlen të sqarojmë, se për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, në datën 20.04.2022 është paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga operatori ekonomik “Autoasja” SHA, i cili kundërshtonte kualifikimin e operatorit ekonomik “Auto Kopaci” PF.

Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ka publikuar formularin e publikimit nr.814/2 prot datë 21.04.2022 lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes “Autoasja” SHA në ankesën me nr. 814 prot., datë 20.04.2022, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik i kualifikuar në procedurë “Auto Kopaci” PF.

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” operatori ekonomik i interesuar “Auto Kopaci” PF, i cili preket nga ankesa e operatorit ekonomik “Autoasja” SHA, në datën 26.04.2022 ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, argumente në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Autoasja” SHA.

Sa më sipër, sqarojmë, se referuar dispozitave ligjore të mësipërme, afati për paraqitjen e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar është 7 (shtatë) ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, afat ky i cili është respektuar nga operatori ekonomik “Auto Kopaci” PF si subjekt i interesuar në këtë procedurë prokurimi.

Referuar nenit 113 pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi. Ndërsa në pikën 5 të nenit 114 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

Sa më sipër, referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ky i fundit me anë të shkresës nr.639/3 prot., datë 05.05.2022 me objekt “Dërgohet vendimi mbi ankesën”, ka njoftuar operatorin ekonomik “Alked Kopaci” PF, si operator ekonomik i interesuar, mbi vendimin e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Autoasja” SHA.

Në rastin konkret, duke qenë se operatori ekonomik i interesuar “Auto Kopaci” PF ka paraqitur argumente brenda afatit të parashikuar në përputhje me nenin 113 pika 1, ky i fundit mund të ushtronte të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Autoasja” SHA.

Sa më sipër, KPP sqaron se, nga ana e operatorit ekonomik “Auto Kopaci” PF janë paraqitur pretendimet në përputhje me nenin 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, por në referim të nenit 114 e konkretisht pikës 5 dhe 6 të tij në të cilin parashikohet shprehimisht se: “[...]5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik. [...]”, operatori ekonomik “Auto Kopaci” PF nuk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, në lidhje me argumentet e paraqitura pranë KPP-së. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Auto Kopaci” PF nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit në përputhje me nenin 114 pika 5 të ligjit për prokurimin publik, në lidhje me vendimin e autoriteti kontraktor për skualifikimin e tij.

Në përfundim, pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, si dhe informacionit të paraqitur nga vetë operatori ekonomik i interesuar “Auto Kopaci” PF, KPP në zbatim të nenit 115 pika 3/b) të Ligjit nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku citohet “3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve

nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”, vendos të mbyllë çështjen në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, për sa kohë autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e tij dhe operatori ekonomik i interesuar “Auto Kopaci” SHPK, i cili ka paraqitur argumente, nuk ka paraqitur ankim në zbatim të nenit 114 pika 5, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Autoasja” Sha., për procedurën e prokurimit me “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me tender kryesor Nr. REF-19189-02-09-2022; ku ankimohet procedura e prokurimit me Nr.REF-19195-02-09-2022 me objekt: Loti II “Blerje bateri për automjete” me fond limit 32,453,736.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 15.03.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
  3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Autoasja” Sha .
  5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**